



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ROSKOVEC

Adresa: Lagjia Nr.1 Qender, Tel : + (355) 038780241, Email : info@bashkiaroskovec.gov.al

PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE 31 TETOR 2022 NE FSHATIN SUK 1

VENDI : Lokali “L.Gllava”

ORA : 17:00

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Per “Hartimin e Buxhetit per vitin 2023” dhe “Hartimin e Paketes Fiskale per vitin 2023”

BAZA LIGJORE : Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në nenin 9 pika 1.3, nenin 34, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar nenin 34 të ligjit nr.68/2017 ”Për financat e veteqeverisjes vendore”, ligjt nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjt nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin finanziar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.08 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendorë 2023-2025”.

Pjesemarres: Kryetarja e Bashkise Znj. Majlinda Buçi, Nenkryetari i Bashkise Z.Maksim Goga, Nenkryetari i Bashkise Z.Klodjan Lushka, Drejtësor i Financave Z.Selman Çepele, Drejtësor i te Ardhurave vendore Z.Marjus Abedinaj. Administratore e NJA Strume, Esmeralda Metushi. Drejtori Ekzekutiv INFOCIP, Z.Gerti Shella, Rreth 50 banore te fshatit SUK 1.

Takimin e hapi Kryetarja e Bashkise **znj. Majlinda Buçi** duke falenderuar për pjesemarrjen te gjithve banoreve te SUK 1 por jo vetem. Keto takime nuk jane te reja per ne, por si detyrim

ligjor dhe gjithashtu per te vendosur priorititetet e punes. Ky takim i sotem eshte mbeshtetur nga Projekti STAR 3/ INFOCIP, te cilet jane te pranishem sot ketu. Jam ketu per te degjuar dhe per te mbajtur shenim cdo kerkese dhe per te reflektuar ne buxhetin 2023, te cilin do ta miratojme ne fillim te ketij viti sipas mundesive financiare qe kemi. Buxhetin duhet ta kemi transparent. Ky konsultim po ashtu eshte mbeshtetur nga INFOCIP (Qendra per ceshtjet e Informimit Publik) te cilet jane sot te pranishem ketu. Sot jam ketu per te mbajtur shenim cdo sugjerim, cdo kerkese qe ju keni, per ti reflektuar me pas ne punen tone.

Gerti Shella / STAR 3 : Shume faleminderit, sot jam ketu per te sjelle modelet me te mira, me te sinqerta, me te dobishme, pervecse per ti dokumentuar por edhe per ti dhene mundesine bashkive te tjera te Shqiperise per te ndjekur pikerisht kete model. Modeli i konsultimit publik qe ka konsoliduar Bashkia Roskovec eshte nje nga modelet e suksesshme ne nje vleresim qe ne beme vitin e kaluar per 61 bashkite e vendit. Synimi jone sot ka te beje me dokumentimin e pote te ketij procesi per te dhene mundesi te gjitha bashkive te tjera te konsultohen me modelet me te mira dhe ti adoptojne per qellimet e tyre.

Drejtor i Financave Z.Selman Çepele: Ky eshte padyshim nje stad shume i rendesishem i punes per bashkine dhe administraten e bashkise per hartimin e buxhetit per 2023 dhe hartimin e paketes fiskale per vitin 2023. Ne si fillim duhet te bejme analizen se cfare kemi arritur deri tani dhe atyre qe duam te arrijme. *Ne total buxheti i bashkise Roskovec per vitin 2023, 2024, 2025, doja te thoja qe ka nje strukture te shpenzimeve ne masen 27% te totalit te pagave shteterore, 32% e shpenzimeve operative ose korrente dhe 41% shpenzime kapitale.* Duke filluar nga viti deri ne vitin 2022 per njesine SUK jane kryer investime ne masen 1 miliard leke, ose 33% e te gjithe investimeve. Nga keto, 348 milione jane kryer investime ne Suk 1, ku perkatesisht jane ndertuar 25 objekte. Nga 25 objekte ne total, 19 jane ndertuar nga te ardhurat konkretisht ne shumen 94 milion dhe 6 objekte te tjera nga fondet e pushtetit qendror. Se fundmi doja te thoja qe kontributi juaj eshte $\frac{1}{4}$ e ketyre investimeve qe kemi bere. Drejtori i Tatim-Taksave do te percaktoje me mire sesa eshte kontributi juaj ne lidhje me taksat.

Drejtori i te Ardhurave Vendore, Z.Marjus Abedinaj: Sa i perket situates ne fshatin Suk 1, te ardhurat qe ju i keni krijuar Bashkise Roskovec jane 23 milion leke te vjetra, nga ana tjeter ju keni krijuar Bashkise nje debi prej 9.2 milion leke, qe do te thote 1 ne tre persona eshte debitor ndaj Bashkise Roskovec dhe shuma vjetore qe cdo familje duhet te paguaj eshte 60 deri ne 100 mijë leke te vjetra ne varesi te siperfaqes se tokes perkateze. Per ta mbyllur doja te thoja se, ne qofte se ne kerkojme sherbime duhet te rrisim kontributet.

Kryetarja: Ne 7 vite jane investuar 384 milion lek te reja ne SUK 1. Keto leke jane hedhur per investimve jo vetem per ato qe duken por per te gjitha duke permendur edhe pastrimin e kanaleve, mirembajtja e rrugve etj. Nga taksat tuaja vetem 25% e tyre jane perdonur per investime. Bashkia Roskovec ka arritur qe nga kompania “Bankers” te marre nje financim fiks duke siguruar nje shume prej 1.1 miliard leke te vjetra. Nga ky financim fiks por edhe nga te ardhurat nga qeveria kemi arritur qe situata eshte permiresuar duke e krahasuar me shtate vite me

pare. Per te ekuilibruar dhe per te perm bushur te gjitha nevojat e banoreve te Roskovecit jemi munduar qe te ardhurat t'i ndajme ne menyre te barabarte. Sot qe flasim, gjerat kane ndryshuar por patjeter qe duhet te permiresohemi. Duhet te puojme me kete ritem dhe ne pak vite do t'i mbyllim dhe te plotesojme te gjitha nevojat. Sot prandaj jemi per te identifikuar te gjitha problemet dhe te prioritizojme ato me te rendesishmet.

Banor, Rexhep Çela: Nje pyetje kam; ju thate qe jane investuar, 384 milion lek, sa leke eshte investuar per lagjen ku une banoj ?



Kryetarja: Per lagjen ku ti banon eshte investuar uji i vadir, dhe per kete biem te gjithe dakord. Sot eshte duke u bere investimi per ujin e pijshem i cili akoma nuk e ka mbyllur afatin e perfundimit te punimit. Ky investim deri ne fund te dhjetorit do te perfundoje. Uji i pijshem do jete prane cdo familje te fshatit Suk. Per pak dite do filloje ndertimi i rruges se Metushes. Duhet te diskutojme sot per te gjitha dhe ti japim prioritet se cilin investim te bejme te parin. Jam shume dakord qe rruga juaj nuk eshte bere por kete vit prioritet do te kete rruga e Metushes. Jemi duke punuar per lagjen Agace. Ju me te drejte keni keto kerkesa, por me jepni ju mua nje per gjigje ne lidhje me pjesen e mospagimit te taksave nga ana juaj.

Banor, Refat Gllava: Kam pakenqesi per deputetin. Ju jam mirenjohes qe na ftuat sot. Me taksat jam dakord dhe e kemi detyrim qe duhet ti paguajme. Kerkoj vemendje per Lagjen Agace, aty ka 800 votues. Gjendja ne ate zone eshte keq. Ju faleminderit!



Kryetarja: Keni te drejte persa i perket lagjes Agacaj, do te jete ne vemandje te punes sone.

Kryetarja:

- **Prezantim per nje insiatiive ne sektorin e bujqesise.** Duke pare sasine e madhe te prodhimeve bujqesore ne kemi marre nje iniciative per te patur ne territorin e Bashkise se Roskovesit nje pike per grumbullin dhe perpunimin e prodhimimeve bujqesore. Nga te gjitha diskutimet qe kam patur me fermeret kemi dale ne perfundimin se kjo eshte nnje nevoje emergjente. Une shpresoj qe ta finalizojme. Pres sugjerime nga ju. Do te jemi bashkia e pare qe do te finalizojme kete proces.
- Sapo kemi perfunduar **prokurimin per te rikonstruktuar shkollen e Suk 1**, nxenesit do te transferohen ne shkollen e Suk 2. Gjithashtu do te kemi ambiente sportive te reja per nxenesit.
- **Kemi ne plan per te realizuar qe te gjithe femijet e Suk 1, Suk2 dhe Agace qe te studiojne ne nje ndertese me vete.** Do te rregullojme edhe transportin ne lidhje me kete ceshje, ne menyre qe procesi mesimor te ec normalisht.
- **Pastrimi dhe Menaxhimi i mbetjeve urbane duhet permiresuar.** Kemi shtuar sasine e konteniereve por do tae vazhdojme te rrisim numrin e tyre. Nga projekti GIZ kemi patur mbeshtetje ne lidhje me menaxhimin e mbetjeve. Nga janari e me tej nuk do te kete makina te hapura per te mbledhur mbetjet por do te arrijme te bleme kamione te mbyllur.
- **Fusha e kompozimit te mbetjeve ne Mariznez eshte bere e mundur me mbeshtetjen e fondacionit GIZ.**
- **Transporti i nxensve gjimnaziste qe studiojne ne Roskovec, kemi menduar ribursimin e biletave te transportit.** Kjo eshte nje iniciatiive per te lehtesuar nag ana ekonomike si nxensit ashtu edhe familjet e tyre.

Keto jane disa nga iniciativat e ndermarra.

Banor, Tefik Metushi: Problemi qe une kam eshte rruga sepse nga 5 meter ka arritur 2 metra. Dua t'ju them se kam 15 dynym serrre, kam te punesar punetore, vjet falimentova, mendoj se nje kanal duhet bere. Kete kerkesa kam.



Degjese publike, Bashkia Roskovec SUK 1, Date
31.10.2022, PJESA 2,

Kryetarja: Rruga juaj nuk eshte bere keni te drejte, ne lidhje me kanalet e treta nuk jane perjegjesi e bashkise, megjithate bashkia do te nderhyje per te rregulluar situaten. Por duu t'ju bej me dije edhe njeher qe ato kanale nuk jane perjegjesi e bashkise, ndersa nese keni konflikt patjeter qe do te zgjidhet.

Banor, Qamil Cjapi : Kanali vadites nuk ka uje, ua kam thene dhe njehere tjeter. Dua te di se sa rruge do behet ? Ku do nise dhe ku do mbaroje? Sepse u fol ne ne vija te perjithshme, dua te di dicka konkrete.

Ne lidhje me ujin e pijshem ne kemi 15 vite qe e blejm. Pyetja qe une kam eshte : Do te kemi uje apo jo? Dhe kerkesa tjeter eshte ne lidhje me kanalet e vaditjes, une aty ku kam token nuk me vjen uji.

Argjinatura e Suk 1 eshte kthyer ne autostrade. Kemi disa toka tek lumi, une i kam paguar taksat, disa te tjere nuk paguajne. Ndersa per mbetjet ne Martinez nuk jam dakord. Gjithashtu ne nuk kemi mjek, gje qe eshte shume e rendesishme.



Kryetarja: Besoj se i bere nje permblehdje te gjitha kerkesave , sugjerimeve, kritikave. Se pari Per mbetjet do te gjejme mundesine me te mire te mundshme, nuk eshte vendosur asgje perfundimtare akoma. Se dyti, per punesimin e mjekut nuk ka burime njerezore. Ne lidhje me ujin e pijshem kemi derguar kerkese prane DSHP-se ne Fier per ta patur ne kontroll. Persa I perket kanalit te vaditjes eshte shqetesim i drejte jemi ne pritje te ndertimit te stacionit. Dhe e fundit persa i perket argjinatures, kemi planikuar nje fond emergjence per te bere disa nderhyrje qe ne i kemi planifikur per sigurimin e argjinatures.

Banor, Tefik Metushi: Faleminderit te gjithve per pjesemarrjen. Persa i perket rruges ne lagjen tone eshte nje rruga qe ka dy kanale kulluese, njeri mendoj se duhet eleminuar ne menyre qe te

behet zgjerimi I rruges. Ka plot pune te mira qe jane bere ka edhe shume te tjera per te bere, mjafton deshira e mire.




Kryetarja: Te gjitha keto qe biseduam sot u mbajten shenim, nuk bejme investime per efekt zgjedhor. Te gjitha kerkesat do te shihen me kujdes. Te gjitha ato sugjerime qe kerkojne vetem vullnet dhe angazhim ne menyre te menjehershme ne do te bejme zgjidhjen e tyre. Ndersa per te tjerat qe duhet investim finaciar do ti jepet prioritet atyre me te rendesishmeve cka do te thote jane 4 rrule per te bere, do te shikohet se pari ajo qe ka nevoje me emergjente. Sipas buxhetit do te bejme edhe investimet.


Drejtori Ekzekutiv INFOCIP, Z. Gerti Shella / Star 3 : Ne garatonjme gjithe takimin ne menyre te dokumentuar. Menyra me e mire per te ndihmuar procesin eshte te prioritizohen kerkesat qe jane me me rendesi. Te gjitha qe ju thatet jane te singerta dhe te verteta. Cfaredo qe nevojtiten nga ana e ketij programi do te garantojme besueshmerine.

Kryetarja mbyll takimin. Ora 19:00

FOTO – GALERIA E TAKIMIT







FALEMINDERIT !

Enerida Kuqo

Koordinator per Njoftimin dhe

Konsultimin Publik

Arlinda Hajdini

Sekretare e

Keshillit Bashkiak



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA ROSKOVEC
KOORDINATOR PËR KONSULTIMIN DHE NJOFTIMIN PUBLIK

Adresa: Qender Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al











Roskovec, më 31.10.2022

Ora: 17.00

Fshat SUK 1

BASHKIA ROSKOVEC

DËGJESË PUBLIKE ME TEMË: - Hartimi I "Buxhetit për vitin 2023" "Hartimi I "Paketës Fiskale për vitin 2023".

Nr.	Emër /Mbiemër	Fshat / Qytet	Firma
1.	Emanuela Gllava	SUK 1	
2.	Shaban Metushi	SUK 1	
3.	Drita Gllava	SUK 1	
4.	Veli Agajev	SUK 1	
5.	Jasmin Rexhepi	SUK 1	
6.	Ajzeni Gllava	SUK 1	
7.	ERVIM Gllava	SUK 1	
8.	Hajt Gllava	SUK 1	
9.	OISI Gllava	SUK 1	
10.	MELSION NOXHA	SUK 1	
11.	EDMOND MALKA	SUK 1	
12.	Aurep Cjapi	SUK 1	
13.	Ferjan Cjapi	SUK 1	
14.	Kimet Mefishi	SUT 1	
15.	BORJANA METU SHI	SUK 1	
16.	Ali Molka	SUK 1	
17.	Shpjetim Dzoni	Suk 1	
18.	Gjergj Matoshi	SUH 1	
19.	Festijn Gllava		
20.	vezmend. BORJNJI		
21.	Tolejona Ruci	Suk 1	
22.	Edisom Zeka	NGJEGAN Prostoloc	
23.	Lorshniot Gjoko		
24.			

25	Edison	Toska	SUK 1	
26	Euros	Vogeo	Suk 1	
27	Rego	Glopo	Suk 1	
28	Yoli	Mefushi	SUK 1	
29	Flamman	Ruko	Suk 1	
30	Angel	Copele	Suk 1	
31	Parmina	Ogusi	Suk 1	
32	Rexperz	Celer	Suk 1	
33	Zellectus	Celer	Suk 1	
34	Saudinet	Cjoro	Suk 1	
35	Gobi	Mekusho	Suk 1	
36	Dognin	Mekusho	Suk 1	
37	Olenine	Ruko	Suk 1	
38	General	Ruko	Suk 1	
39	Dashmin	Malko	Suk 1	
40	Kiam	Malko	Suk 1	
41	Elis	Cllan 9	Suk 1	
42	Joshmon	Selano	Suk 1	
43	Bnamin	Cllan 9	Suk 1	
44	Ols	Cllan 9	Suk 1	
45	violeta	Cjoro	Suk 1	
46	Braym	Cjoro	Suk 1	
47	Dantein	Mekusho	Suk 1	
48	Fotonin	Mekusho	Suk 1	
49	Hkclqin	Cjoro	Suk 1	
50	Sofiel	Malko	Suk 1	
51	Xhevalol	Cjoro	Suk 1	
52	Aenam	Mekusho	Suk 1	
53	Bangut	Cllan 9	Suk 1	
54	Marius Abding		Dryas ite and birds calls	
55	Tajh'm	Tcamon	Suk 1	
56	Seluan	Copele	P. Roskewec	
57	Proliids	Be P.	Dyntor Bulle	
58	Yulerolda	Nafushi	Admr nistator NAS	
59	Cars	Steller	IMPOGP	
60	Klodgen	Lysyn ho.	X' ksy vctoz.	
61	Anit	Haxid	Suk N°1	
62	Tca	Rasholli	INFOCIP	
63	Enaido	Stoxho	Suk 1	
64				